




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.56/2023
Datë:05.06.2023

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, në mbështetje të, neni 26, nenin 27, nenin 35,39 nenin 55 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 08/L-056 (Gazeta zyrtare Nr.14/2022), Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant. Bazuar në kërkesën e datës 14.03.2023, me Nr. Prot. 104/23-01/H për Njoftim të Përqendrimit, përmes z. Korab Rexhepi, përfaqësues Ligjor me autorizim, nga ndërmarrja ALFI PE d.o.o, specialni investicijski sklad k.d dhe AMC V Master LuxCo S,ar,l, (Slloveni) lidhur me Fitimin e Kontrollit mbi ndërmarrjen VEMO TRADE sh.p.k. (Kroaci), Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, në mbledhjen, e datës 05.06.2023, mori këtë:

VENDIM

I. LEJOHET, Përqendrimi i ndërmarrjeve: ALFI PE d.o.o. specialni investicijski sklad k.d dhe AMC V Master LuxCo S.ar.l., lidhur me Blerjen e 100% të Aksioneve mbi ndërmarrjen Vemo Trade sh.p.k.

Njoftimi për Përqendrim, është i bazuar në Kontratën për Shitblerje të Aksioneve, të lidhur më datë: 15.03.2023.

ALFI PE d.o.o., specialni investicijski sklad k.d. është shoqëri tregtare e regjistruar në përputhje me ligjet e Republikës së Sllovenisë, me adresë: Verovshkova 55A,1000 Ljubjana, Slloveni, dhe numër të regjistrimit të biznesit 24675369.

AMC V Master LuxCo S.ar.l., është shoqëri tregtare e regjistruar në përputhje me ligjet e Republikës së Luxemburgut, me adresë: Boulevard F.W. Raiffeisen 15, dhe numër të regjistrimit të biznesit 32211597726.

Josipa Juriq, me adresë në: Koprivnica, Trg bana Josipa Jelaçiqia 13, dhe numër të regjistrimit 8356610493.

VEMO TRADE sh.p.k., është shoqëri tregtare e regjistruar në përputhje me ligjet e Republikës së Kroacisë, adresë: Ivana Gjrkana 9 Koprivnica, e regjistruar në regjistrin gjyqësor të Gjykatës ekonomike në Bjelovar me numër biznesi 010013669.

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21,10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: info.konkurrenca@rks-gov.net

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguajë taksën administrative prej 100.00 € me shkronja (*njëqind euro*) dhe Autorizimin për realizimin e përqendrimit në përputhje të nenit 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 20 të udhëzimit Nr. 06/2012, bëhet kundrejt pagesës, në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja, (*tre mijë*) Euro.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, më datë: 14.03.2023, ka pranuar kërkesën, me Nr. Prot. 104/23-01/H për Njoftim të Përqendrimit, përmes z. Korab Rexhepi Përfaqësues Ligjor i autorizuar nga ndërmarrja ALFI PE d.o.o, specialni investicijski sklad k.d. dhe AMC V Master LuxCo S,ar,l, lidhur me Fitimin e Kontrollit mbi ndërmarrjen VEMO TRADE sh.p.k.

Procedurat e ndjekura:

- a) Vlerësimi i Lëndës
- b) Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 18.04.2023
- c) Njoftimit për realizimin e përqendrimit në ueb faqen e AKK-së, me datë 12.04.2023
- d) Më datë 15.03.2023, palët kanë nënshkruar Marrëveshjen për Blerjen e Aksioneve të VEMO TRADE sh.p.k. nga ALFI PE d.o.o, specialni investicijski sklad k.d. dhe AMC V Master LuxCo S.ar.l.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a) Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
- b) Qarkullimi i njëres palë, respektivisht palëve në Përqendrim e kalon, shumën 1,000,000 Euro
- c) ALFI PE SIS d.o.o, specialni investicijski sklad k.d. dhe AMC V Master LuxCo S,ar,l (blerësit) “do të blejnë së bashku 100% të aksioneve të VEMO TRADE sh.p.k (targeti) nga Josipa Juriq, (shitës).
- d) Kontrata e nënshkruar ndërmjet palëve, me datë: 15.03.2023.
- e) Kërkesa për Përqendrim është bërë për arsye se blerësi është prezent përmes shitjeve në territorin e Republikës së Kosovës.

Vlerësimi i Konkurrencës

Aplikuesi dhe Shoqëria e Synuar, nuk kanë rrjet të prodhimit, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë në tregun relevantë të prodhimit të letrës/qeseve, në Republikën e Kosovës.

Tregu Relevant - Struktura e tregut do të mbetet e pandryshuar në Republikën e Kosovës

Autoritet i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21,10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: info.konkurrenca@rks-gov.net

Tregu i produktit - tregu për prodhimin e produkteve të qeseve të letrës, qeseve industriale, etj.

Tregu gjeografik - treg përkatës gjeografik është definuar si treg i hapur, por pasi që transaksioni me ndërmarrjen e themeluar dhe aktivitete e saj kanë qasje direkte tek konsumatorët në Republikën e Kroacisë i njëjti, do të përcaktohet edhe si treg gjeografik. Tregjet e Prekura -Transaksioni, nuk do të shkaktojë ndonjë rritje të pjesës së tregut, pra do ta ruaj pozicionin aktual në tregun relevant në Republikën e Kosovës, pasi që transaksioni realizohet jashtë territorit të Kosovës, për arsye se objekti i kontratës ndërmjet palëve në Përqendrim, është prodhimi, shpërndarja dhe shitja me pakicë në tregun relevant të letrës, përkatësisht prodhimi i qeseve të letrës.

Efektet e konkurrencës, në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Kroacisë, kërkesa për njoftim të përqendrimit, është bërë për arsye se palët në përqendrim janë prezent në Republikën e Kosovës, përmes shitjeve. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk do të kenë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht, nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës.

Divizioni i Përqendrimeve ka vlerësuar se, ky transaksion nuk do të paraqesë efekte negative në konkurrencë për arsye se ky transaksion/blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse, tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

Shënim: Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim merr epilogun, si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga, Komisioni.

Autoriteti i Konkurrencës
Komisioni

Neime Binaku-Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare



Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva

Autoritet i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: info.konkurrenca@rks-gov.net